Lezhë, më 25.05.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, më dt. 25.05.2022, në orën 13:00, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF) mbi mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë, për muajin Maj 2022.

Mbledhja u hap nga kryetari i K.B. Lezhë z. Ernest Rroku, i cili lexoi rendin e ditës.

Ernest Rroku: E hedhim në votim?

Agostin Markaj: Me leje

Në mbledhjen e mëparshme të këshillit, kryetari i Bashkisë ishte prezent për disa çështje të organizimit dhe mënyrës së funksionimit të këshillit dhe marrëdhënies së këshillit me Bashkinë. Kryetari i Bashkisë, ndër të tjera, konkludoi, edhe në bazë të debateve e diskutimeve që ne patëm këtu, që në mbledhjet e këshillit të jenë vazhdimisht drejtuesit e sektorëve apo drejtorive që ka bashkia, në mënyrë që edhe të mbrojnë projekt-vendimeve por edhe për t'iu përgjigjur tematikave të ndryshme që mund të ketë Këshilli i Bashkisë. Së pari, unë vë re se që nuk e kemi këtë prezencë. Së dyti, një ndër problemet ishte funksionimi i komisioneve të këshillit. Kjo nuk është detyrë e bashkisë por është detyrë e Këshillit. Ju, shumë mirë, ka disa kohë që si kryesi e këshillit keni filluar ta shumoni edhe në rendin e ditës, të lajmëroni këshilltarët edhe për problemet

e organizimit të komisioneve, në fakt edhe rregullore e këshillit e ka për një projekt-vendim nuk mund të kalojë në këshill pa pasur shqyrtimin paraprak të komisionit përkatës. Unë shoh për këtu mbledhjet janë planifikuar një ditë para, krejt në rregull, janë brenda procedurave, por ne nuk kemi asnjë dokument për ne të votojmë miratimin sipas rendit të ditës.

Ernest Rokaj: Po të përgjigjem unë.
Kur është prezent ZV/kryetari i Bashkisë në mbledhje, nuk besoj se është e nevojshme të jenë drejtorët e bashkisë.
E dyta, komisionet janë mbledhur. Nëse nuk të janë vënë në dispozicion relacionet përkatëse, herë tjetër do i kesh.

Ermal Pacaj: Për sa i përket pjesës së drejtorive, janë prezent drejtorat që kanë sjellë projekt-vendime. N.p.s. çdo drejtor i Bashkisë thirret nga këshilli për të raportuar, ai është i detyruar për t'u paraqitur e për të dhënë llogari.

Ernest Rokaj: E kalojmë në votim rendin e ditës, ju lutem.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika e parë e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për përdorimin e

fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
deri në 6% për periudhën 01-30 Prill 2022".
E kalojmë në votim
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 2 e rendit të ditës për
çështjen projekt-vendim "Për një shtesë në vendimin
nr. 3, datë 01.02.2022 "Për miratimin e listës
së të pastrehëve që përfitojnë subvencionim të
qirasë për vitin 2022"".
Agostin Marku: Jam shumë dakord që të
trajtohen këto subvencionet për të pastrehët,
ça lloj politike ndiqet nga Bashkia, e para.
E dyta, në këtë kuadër a është menduar
nga bashkia një program më afatgjatë që ne të
mendojmë për çështjen e zgjidhjes së strehimit,
me këto politikat e buta, pastaj edhe me
bashkëpunimin e Entit Kombëtar të Banesave,
që ne mos të vimë në përfundim duke dhënë
lekë por realisht nuk kemi bërë zgjidhje.
Esmeral Pacaj: Për sa i përket politikës që
ndiqet nga Bashkia për subvencionimin e të
pastrehëve, janë një seri kriteresh ligjore
që ata duhet të plotësojnë që të përfitojnë.
Sa i përket pyetjes së dytë, ne jemi në
një komunikim intensiv me Entin Kombëtar
të Banesave, kemi parë edhe vendet që janë
të lira që Enti mund të operojë, por kjo

nuk jep dot zgjidhje përfundimtare sepse aplikantët janë shumë. Gjithashtu është edhe programi i kredive të buta

Këshilltari Agostin Markaj vazhdoi diskutimin në lidhje me çështjen e strehimit
Nga kryetari z. Rakaj u tërhoq vëmendja që rasti është me urdhër mbrojtje nga gjykata dhe që mund të futet në interpretime drejtoria përkatëse për atë që ai aplikon.
Hasan Muça: Kemi të bëjmë me një rast me urdhër mbrojtje por jam dakord me parafolësin sepse ne nuk duhet të mendojmë vetëm zgjidhje momentale. Një plan më i detajuar dhe një bashkëpunim me Entin e Banesave nga bashkia, mund të bëjë që ne të zgjidhim sado pak çështjen sociale të këtyre familjeve. Unë e di shumë mirë që kjo nuk mund të zgjidhet dot brenda një viti, por në programet afatmesme.
Ermal Pacaj: Nuk është në planet afatgjata apo afatmesme. Është në planet sot. Problematika kryesore është që nuk ka shesh ndërtimi. Në dy vende ekzistojnë mundësia, te rrethrrotullimi te "Papa Gjon Pali", por a të bëhet kapak apo qendër se ka nevojë dhe kjo është problematike.

Rigels Nicaj: Te pallatet e tërmetit, a nuk shtohen edhe 2 kat për të pastrehët?

Ermal Pacaj: Jo, është program tjetër ai.

Ernest Rokaj: Meqë nuk ka dikush tjetër diçka për të shtuar, e kalojmë p/vendimin në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për përdorim të fondit të emergjencës për "Rehabilitimi i murit mbajtës, në fshatin Spiten, Njësia Administrative Zejmen"".

Agostin Marku: Unë në parim jam dakord, por relacioni është për një emër kontrate, kur lexoj p/vendimin, nuk më del emri, për një mur rrethues në Spiten.

Marta Simoni: Nuk kam asnjë vërejtje për ndihmën e për vlerën. Duhet të ishte pak më konkret si projekt vendim. Edhe relacioni është i pashpjegueshëm fare. Është ngritur një komision. Se çfarë kanë dashur të bëjnë, nuk e kuptoj.

Andi Marku (Sp. i Dr. së Emergjencave) - Komisioni është ngritur për shtetasin në fjalë. Ka ardhur komisioni nga Gjeoshkenca për ndërprerje rreth 80 m sepse rrëshket rruga. Nuk ka lidhje me ndihmën shtetasin por ka lidhje me shpëtim banesat. Është në funksion të parandalimit, për të shmangur shembje banesash dhe rënie të rrugës. Është bërë

projekti, me studime teknike, është gjithë dosja përkatëse në zyrën tonë. Ne kemi kërkuar nga këshilli, për nga fondi, të bëjmë parandalimin, ndërhyrjen e cila do bëhet me prokurim. Nuk do marr leket pyetesi.
Ernest Peçaj - Jep shpjegime në bazë të dokumentacionit bashkëngjitur projekt-vendimit.
Agostin Marku: Është çështje e konceptimit, por se i gabuar, në parim asnjë nga këshilltarët nuk thotë të mos miratohet.
Prandaj kemi për të vijuar specialistët në mbledhje këshilli, se ato nevojiten për këtë punë.
Duhet të ishte Dr. e Financës për e shpjegonte p/vendimin nga ana financiare.
Ernest Peçaj: E kalojmë p/vendimin në votim
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës për është projekt-vendim "Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasit Z.E.P, Z.A.N, Z.Gj.N nga fondi i emergjencës", kemi të bëjmë edhe në këtë rast me një p/v nga Dr. e Emergjencave për dhënie ndihme për djegie banesash.
Meqë nuk ka dikush diçka për të thënë, e kalojmë p/vendimin në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës, për është projekt-vendim "Për miratimin në parim të vënies në dispozicion të pasurive, fondit të pasurive të

pakuajtshme, për mbështetjen e investimeve strategjike, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë".

Esmal Paçaj: Për pjesën teknike është drejtori i Projekteve në Bashkinë e Lezhës, i cili do mbajë relacionin. Është një projekt që ka kaluar në Këshill edhe në fazën e mëparshme. Është një projekt që po merr formë, si një projekt strategjik, që në fakt kalon me vendim të ministrisë, jo të bashkisë. Bashkia e ka politikë prioritare për t'i dhënë dritën jeshile këtij zhvillimi shumë të rëndësishëm, që në fakt përveç se ndikon në buxhetin e bashkisë me taksën e infrastrukturës që është pasha e konsiderueshme, i hap rrugë shfrytëzimit të një resursi të jashtëzakonshëm natyror që na kemi, siç është energjia me erë. Për pjesën tjetër është Drejtori i Projekteve, Elson Frroku që do flasë.

Elson Frroku: Përshëndetje të gjithëve.

Të nderuar kryetar, të nderuar këshilltarë ky është një projekt-vendim që këshillit i është paraqitur, i cili, më duhet ta them, është i njëjti p/vendim por me disa ndryshime, të cilat na i morëm si pasojë e një procedure për të cilën nuk ishim të njohur më parë. E për pasojë, siç ndodh zakonisht me projektet të kësaj natyre, një nga procedurat kryesore edhe për shkak të vetë ligjit 139/2015, është miratimi i këshillit.

Bëhet fjalë për një park eolik, park me erë, ose e thënë më thjeshtë, për ndërtimin e një hapësire ku do vendosen rreth 24 turbina me një lartësi deri në 90 m, por kjo pak rëndësi ka. Ajo çka është e rëndësishme sot për t'u diskutuar, bëhet fjalë për një projekt strategjik i cili nga vendimi i Komisionit të Investimeve Strategjike (KIS) në shkurt 2021, është dhënë pëlqimi dhe është miratuar për të marrë këtë status. Pikërisht në këtë vendim, një nga detyrat që i është lënë grupit operacional, ku Bashkia Lezhë ka qenë pjesë, e veçanërisht Bashkisë Lezhë me përgjegjësi për të përshpejtuar procedurat për ta çuar më tej dhe për ta bërë gati për Ministrinë e Financave. Bashkia Lezhë bëhet përgjegjëse për [illegible] gjurmën ku prek projekti dhe për të evidentuar ato prona që janë në pronësi të Bashkisë Lezhë. Vlera që ka ky projekt është rreth 240 mln euro investim që do shtrihet në 3 njësi administrative, Shëngjin, Kallmet dhe Balldren. Do prekën Mali i Rrencit dhe Mali i Kakarriqit, të cilët do kenë dhe një peisazh panoramik, jo vetëm se do jetë funksionale. Për pasojë, nga plani i biznesit që është miratuar nga KIS, përveç investimit që më sapo e theksë, ku bashkia do ketë përfitimin e mbledhjes së taksës së infrastrukturës dhe çdo gjë që vazhdon, diskutohet për punësimin e minimalisht 350 personave.

Kështu që kjo duket që e kalon përmasën e organizimit të një bashkie.

Rigels Nicaj: Pyetja ime është: cili është përfitimi direkt apo indirekt i projektit në Bashkinë e Lezhës, duke qenë se bashkia transferon shumë prona dhe asete të saj te Ministria e Financave, për këtë investim strategjik nga biznesi privat. Sa do jetë efiçiente dhe sa do jetë vlera e investimeve që do kthehen te Bashkia Lezhë nga dhënia e këtyre aseteve, sepse me sa kam parë unë, janë gati 50 prona. Jam dakord unë, nuk jam kundër propozimit.

Esmel Pacaj: Llogaritet që 300 vende pune të hapen, që jep, qoftë direkt, qoftë indirekt impaktin e vet në këtë projekt. Të ardhurat, parashikohet që vetëm taksa e infrastrukturës që Bashkia Lezhë përfiton të jetë diku rreth 2 mln euro, që kjo shumë përkthehet në shumë punë publike në Bashkinë e Lezhës. Në fakt i përmendi dhe Elsoni përpara.

Ne jemi në një situatë ku kemi një projekt serioz që Bashkia e Lezhës patjetër që e përkrah, për arsyet që citova më përpara dhe a e merr apo nuk e merr, janë kritere të tjera ligjore shumë serioze dhe strikte.

Hasan Muça: Unë jam interesuar në lidhje me këtë projekt. Ky projekt ka diçka risi. Është

projekt që aplikohet për herë të parë në Shqipëri dhe Lezha është e para që e implementon këtë gjë. Në dijeninë time projekti prekte një tjetër bashki. Ishte këmbëngulja e Bashkisë Lezhë që të gjitha përfitimet t'i përfitonin vetë dhe jo ndonjë bashki tjetër. Nga ana tjetër, jashtë duhej ministri linjë të cilët kanë bashkëpunuar me njëra-tjetrën. Këtu do përmend edhe rastin e Ministrisë së Mjedisit. Juna thashë këtë gjë për t'ju treguar se sa serioz është ky projekt. Ministria e Mjedisit në një moment të caktuar ka patur një kundërshti sepse në një segment rrugor ajo kalonte një shpend shumë i rrallë i cili vinte për shtegtim në zonën tonë, dhe nuk pranonte që të nënshkruante marrëveshjen, por ata kanë qenë ap të kujdesshëm sepse kanë parë edhe çështje të ekosistemeve, që lidhen me florën, me faunën. Me vendosi është edhe çështje e punësimit të njerëzve. Unë tregojt kaq zbatimin se më shqejt të këtij projekti.

Agostin Marku: Nuk ishte pyetje. Hasani të mbështetë. Në pikën 4 thuhet që VKB 97/2021 shfuqizohet. Së dyti, ky vendim që ne miratojmë sot, a do ishte më mirë të ishte shtesë e një vendimi, pasi atë vendim që ne e kemi marrë diskur. Meqë jemi live, një pyetje më shumë - a ke konsultim paraprak me publikun.

Jepen fitues këto pasuri, mendohet të bëhet një investim strategjik, a është bërë konsultimi paraprak me publikun?
Tjetër: Përmenden një sërë pasurish, kullat, Bolldo, Shëngjin, dhe ato gjërë peng për të realizuar këtë. Sa është vlera e fituesit. Ne kemi një relacion të thatë, ama nga ana ligjore është krejt në rregull sepse një 2 faqe i kemi me referenca. Diçka praktike, që dhe ne në vendimmarrje të gjemë të partë, nuk kemi. Uroj që të realizohet projekti. Ky është një projekt strategjik. Nuk është pak edhe punësimi i 300 vetave sepse zgjidh problemet sociale. Miratojmë në parim tani, por çfarë shtypizojmë ne sot (VKB 97)?
<u>Ermal Pacaj</u>: Për pjesën e konsultimit dhe për pjesën e vendimit që ka kohë që përkullon, z. Agostin, ligji për investitorin strategjik ka pak vite që është miratuar. Edhe për pjesën e konsultimit është e rregulluar gjithçka me ligji.
Ne japim pëlqimin si bashki, për t'i hapur rrugë një projekti që të marrë statusin e investitorit strategjik. dhe kjo përmban disa kritere dhe pjesa e konsultimit publik vjen pasi ne të japim pëlqimin. Sepse me pëlqimin nuk i dha pronën. Kompania ka një sërë kriteresh që duhet të plotësojë, që do ndërtojë projektin. Janë shumë hallka që duhet të kalojnë deri te ndërtimi.

konsultimet [illegible] që do bëhen. Në momentin që lind nevojë për transferimin e pronave, prapë kthehet me 3/5 do vijë.

Elson Frroku: Duhet të kemi parasysh që bashkia nuk është autoriteti kontraktor. Bashkia është palë suportuese për sa i përket vendimeve të marra nga KIS. Është një komision i ngritur me ligj të veçantë i cili shqyrton të gjitha ofertat që bëjnë operatorët të ndryshëm për të pasur investime strategjike.

Për sa i përket çështjes së shpronësimit, këshilltari kishte të drejtë. Janë disa forma se si mund t'i drejtohesh këshillit, për të korrigjuar apo për të ndryshuar, apo për të hedhur poshtë një vendim. Ne gjykuam të arsyeshme kështu, për të marrë le të themi, një vendim më të plotë, duke mos shkuar nga njëri tek tjetri, nga vetë fakti se te vendimi i parë që është marrë, nuk kemi patur një pasqyrë të saktë të statuseve juridike të pronave përkatëse.

Në këtë moment që flasim, i kemi idre ne i jemi drejtuar sot këshillit vetëm për pronat që janë në pronësi të Bashkisë Lezhë. Por kjo nuk do të thotë që projekti është vetëm te këto prona.

Anton Ndreu: Jam pro projekteve strategjike, por a duhet të pyeten ato pronarë?

Ernest Rekaj: Këto prona janë të bashkisë.
Aleksander Kolvataj: Cilat janë të bashkisë kryetar?
Ermal Paca: Çdo iniciativë e marrë është brenda kornizave ligjore.
Hasan Muça: E drejta e pronës në Shqipëri rregullohet me ligj: kush jemi ne, që të vendosim për pronën e privatit. Ne kemi të drejtë të flasim vetëm për pronat që janë pjesë e bashkisë.
Agostin Marku: Në raport me anën ligjore, unë nuk bëra vërejtje.
Ne nuk mund të marrim vendim për prona private. Kur vendoset investimi strategjik, bashkia, pavarësisht merr vendimin për shpronësim publik. Këshilli është organ vendimmarrës dhe ka detyrimin për të bërë konsultimin me pyetësorët për tjetërsimin e pronave, për investime të tilla.
Ne e dërgojmë atje për po, nëse kemi komunitetin që thotë jo. Atëherë kemi një kontradiktë të madhe.
Unë mendoj, n.q.s e kaloni gjithsej, pikën 1 dhe pikën 2 ndryshojini.
Ermal Paca: Ne e kemi tagrin për t'jua sjellë këtu për të vendosur për pronat publike.
Ne i kemi me shkresë hartave nga ASHK.
Ne kemi sjellë një PV në Këshill dhe mendojmë se jemi shterues.
Aleksander Kolvataj: Ne kemi tokat atje që

nuk kemë mujt me i ba dokumentet.
→ Dolën këshilltarët Redi Brunga e Vera Pica.
Ernest Rakaj: Duke pasë se ky p/vendim kërkon shumicë të cilësuar dhe shoh se ka edhe jomarrëveshje e detyrimet për mbledhjen tjetër të radhës.
kalojmë te pika 6 për është projekt-vendim "Për lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Lezhë, Shqipëri dhe Bashkisë Büyük-çekmece, Turqi".
Elson Frroku: Drejtoria jonë është në komunikim të vazhdueshëm me bashkinë për kemi ngjashmëri me Bashkinë e Lezhës. Kjo bashki është në periferi në Stambollit. nga e cila kemi marrë ftesë zyrtare. Atë e kemë njoh vendimmarrjen. kemi hartuar edhe marrëveshjen pasi kemi marrë aprovimin nga Ministria për Europën. Nuk ka efekte financiare.
Agestin Marku: Në parim jam shumë dakord. Uroj për ky rast mos të mbesë në letër.
Ernest Rakaj: E kalojmë në votim
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Mbledhja u transmetua live në Facebook, në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ
[signature]

KRYETARI
Ernest Rakaj
[signature]